



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 126, Datë 31.05.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “b” dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1 gërma “d”, nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/3 prot., datë 27.05.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me Nr. 390 Seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 174, datë 26.10.2017”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 66, datë 11.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/8 prot., datë 13.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.04.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë

*elektrike*” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8 , gërmat “a”, “c”, “d”, “f”, “h”.

Në lidhje me mungesën e konstatuar në Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- gërma “a” (vërtetim për shlyerjen e Tatim - Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim që të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.**

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike - neni 9 , pika 4.7

- gërma “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.) **Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim të që të përcjellë brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit, dokumentat që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.**
- Shoqëria “Energy Financing Team Tiranë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 390 Seria F17, në veprimtarinë së furnizimit të energjisë elektrike që nga data 26.10.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 26.10.2022.
- Në nenin 16, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Sikurse konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 10.02.2022, gati 8 (tetë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores ndaj si e tillë vlerësohet që në dispozitiv të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së licencës duke filluar nga data 27.10.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesen e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në Aneksin A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjise elektrike”* e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën nr. 390, Seria F17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit nr. 174, data 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.
2. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.
3. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijëni e vendimit, dokumenta që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.